



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.0.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Emine Fazliu, e mbështetur nga Ilir Abazi - Udhëheqës Ekipi, Shemsije Llugiqi dhe Erëmira Bytyqi - Pllana -Antarë Ekipi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	18
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZAP	19
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	22
Shtojca IV: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it.....	24


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës (KRRK) për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Sekretarin e Përgjithshëm të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me standardet e auditimit në Sektorin Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 21/10/2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.


Opinion i Auditorit të Përgjithshëm:

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi në pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Sekretarit të Përgjithshëm të KRK-së – auditimi 2015

Sekretari i Përgjithshëm i KRK-së ka marrë në konsideratë të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit.

Komentet e Sekretarit të Përgjithshëm ndaj atyre rekomandimeve me të cilat është pajtuar pjesërisht janë dhënë në detaje në Shtojcën IV.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat vjetore financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat vjetore financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave buxhetore në Kosovë. ZAP është i pavarur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Menaxhmenti i KRRK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Sekretari i Përgjithshëm i Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Nga Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkohet të veprojnë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013 për pasqyrat vjetore financiare të organizatave buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me SNKSP dhe kërkesat tjera të kornizës së raportimit;
- Kërkesat buxhetore;
- Raportet tremujore, përfshirë edhe raportin nëntëmujorë financiar (PNF);
- Planin vjetor të prokurimit dhe raportin vjetor për kontratat e nënshkruara;
- Raportimin mujor të obligimeve të papaguar; e të tjera.

Në kontekst të PVF-ve, por edhe të kërkesave tjera për raportim të jashtëm ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto.

Marrë parasysh çka u tha më lart, deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e saktë.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për KRK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetëvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

- Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në shumicën e fushave janë dizajnuar sisteme të kontrollit të brendshëm të cilat sigurojnë bazë për menaxhim adekuat. Menaxhmenti ka qenë i përkushtuar në trajtimin dhe adresimin e shumicës së qështjeve të ngritura në raportin e auditimit të vitit paraprak. Me gjithë progresin e arritur dhe avancimet në qeverisje, zhvillim të mëtejshëm të kontrolleve kërkohen në procesin e planifikimit dhe menaxhimit të blerjeve përmes prokurimit publik si dhe menaxhimit të pasurisë. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, do të ishte zhvillimi i mëtejshëm i planit si përgjigje efektive ndaj rreziqeve të mundshme.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 ka rezultuar në nëntë rekomandime. KRK ka përgatitur një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve si dhe ka monitoruar zbatimin e atij plani. Përveç rekomandimit lidhur me regjistrimin e plotë të pasurisë jo kapitale në sistemin e-pasuria, rekomandimet tjera ishin impelementuar. Gjatë vitit 2016 menaxhmenti kishte ndërmarrë veprime në adresimin edhe të këtij rekomandimi. Në auditimin e radhës ne do të vlerësojme implementimin e rekomandimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministrinë e Financave, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi. Menaxhmenti i KRK ka bërë vetvlerësimin vjetor të organizatës duke dhënë shpjegimet për secilën komponentë të listës kontrolluese.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit KRK operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara me procedurat e MFK dhe rregullës 01/2010, kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Çështja 1 – Menaxhimi i rrezikut – Prioritet i mesëm

E gjetura	KRK ka hartuar një dokument me të cilin ka identifikuar sfidat apo vështirësit me të cilat përballet gjatë aktiviteteve të përditshme, por se në atë regjister nuk janë dokumentuar masat apo veprimet që synohen të ndërmirren në tejkalimin e tyre.
Rreziku	Veprimet e nevojshme për të parandaluar ose eliminuar rreziqet e mundshme mund të mos ndërmerren me kohë, në mënyrë sistematike dhe të organizuar.
Rekomandimi 1	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë avancimin e mëtutjeshëm të planit për menaxhimin e rrezikut, duke përfshirë në të edhe masat dhe veprimet që menaxhmenti planifikon të ndërmarrë në tejkalimin e sfidave të identifikuara.

2.5.2 Raportimi menaxherial

Për të siguruar funksionimin e sistemit financiar dhe kontrollit duhet të zbatohen një sërë kontrollesh të brendshme. Është e rëndësishme që ato kontrole të përfshijnë një strukturë efikase organizative, delegimin e duhur të përgjegjësive dhe raportimin e rregulltë tek menaxhmenti, për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj sfidave dhe problemeve operative të identifikuara.

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemi i kontrollit është duke funksionuar. Organizimi i brendshëm është në përputhje me strukturën organizative dhe se linjat e raportimit dhe përgjegjësit janë vendosur. Menaxhmenti është i informuar rreth menaxhimit të aktiviteteve operative përmes raporteve të punës të përgatitura nga secili nivel organizativ i KRK-së.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Për një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera, dhe se ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar e Komitetit të Auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në KRK përbëhet nga një auditor. Auditori i Brendshëm (AB) ka përgatitur planin vjetor dhe strategjik. Plani vjetor i auditimit ishte bazuar në shkallën e nivelit të rrezikut për sistemet dhe proceset e përfshira nën auditim. Në planin vjetor NjAB kishte planifikuar auditim në: menaxhimin e buxhetit dhe shpenzimeve, prokurim, menaxhimin e personelit dhe aktivitetet e drejtorisë së shërbimeve teknike. Plani i auditimit ishte përmbushur në tërësi. AB kishte bërë edhe një vlerësim të adresimit të rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të auditimit.

Përmes raporteve të auditimit menaxhmentit i janë ofruar informata dhe vlerësime për funksionimin dhe efektivitetin e kontroleve të brendshme. Çështjet e ngritura në raportet e auditimit të brendshëm ishin vlerësuar dhe trajtuar edhe nga Komiteti i Auditimit.

Çështja 2 - Implementim i ulët i rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm - Prioritet i mesëm

E gjetura	Auditimi i Brendshëm kishte vlerësuar implemetimin e rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të auditimit të brendshëm duke konstatuar se pjesa më e madhe e rekomandimeve nuk janë adresuar.
Rreziku	Mos adresimi i rekomandimeve do të shkaktojë përsëritjen dhe vazhdimin e mangësive aktuale.
Rekomandimi 2	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se secila njësi e audituar ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në implementimin e plotë të rekomandimeve të AB-së.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin II, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Në përgjithësi kontrollet e brendshme janë të vendosura, zbatohen dhe janë duke funksionuar. Megjithatë, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Planifikimi dhe realizimi i blerjeve përmes prokurimit publik dhe menaxhimi i pasurisë jokapitale mbeten çështje që kërkojnë vëmendje të shtuar të menaxhmentit për përmirësim të mëtejshëm me qëllim evitimin e mangësive aktuale.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimi i Fondit:	8,731,365	8,361,475	7,951,987	6,470,018	17,307,643
Granti i Qeverisë -Buxheti	8,731,365	8,361,475	7,951,987	6,470,018	17,301,343

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 369,890€. Ndryshimi i buxhetit është bërë me rishikimin buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

KRK ka shfrytëzuar 95% të buxhetit final, duke shënuar një ngritje prej 14% në krahasim me vitin paraprak (81%). Në tabelën më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale buxhetore.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondit sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e buxhetit sipas kategorive ekonomike:	8,731,365	8,361,475	7,951,987	6,470,018	17,307,643
Pagat dhe Mëditjet	6,398,365	6,060,091	6,060,091	4,932,396	5,101,873
Mallrat dhe Shërbimet	1,758,000	1,534,147	1,124,772	966,860	1,563,205
Shërbimet komunale	221,000	180,322	180,280	143,626	183,971
Subvencionet dhe Transferet	30,000	120,000	120,000	6,800	9,820,900
Investimet Kapitale	324,000	466,915	466,844	420,336	637,692

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.4 Prokurimi

Rregullat e prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit.

Gjatë vitit 2015 KRK ka nënshkruar 47 kontrata publike. Prej tyre, për 17 kontrata janë zhvilluar procedurat e hapura të prokurimit, tetë përmes procedurave të kuotimit të çmimit, katër me procedurë të negociuar dhe 18 kontrata me vlerë minimale. Kryesisht procedurat e prokurimit janë zhvilluar sipas kërkesave të LPP-së, me përjashtim të disa aspekteve të këtij procesi mbi të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrën e duhur.

Çështja 3 – Dobësi në prokurim dhe menaxhim të kontratës – Prioritet i mesëm

E gjetura Në planin vjetor të prokurimit, përshkrimi i disa blerjeve/kontratave të planifikuara për realizim gjatë vitit ishte i përgjithësuar. Nuk ishin detajizuar nevojat apo lloji i furnizimeve dhe shërbimeve për tu realizuar brenda vitit fiskal përmes procedurave të prokurimit. KRK kishte zhvilluar tre² aktivitete të prokurimit, të pa përfshira në planin final të prokurimit, duke mos e njoftuar Agjencionin Qendror të Prokurimit (AQP)³.

Gjithashtu, si rezultat i vonesave në përgatitjen e specifikacionit teknik nga njësia kërkuese, kontrata kornize për *“Mirëmbajtjen Mujore të Ëeb Faqes së Kuvendit të Kosovës”*, është vazhduar me aneks kontratë⁴, deri në përzgjedhjen e kontraktuesit përmes procedurave të rregullta të prokurimit. Vonesa në iniciimin e procedurave të prokurimit si rezultat i mos përgatitjes së plotë dhe jo me kohë të specifikave teknike kishte edhe në raste tjera.

Mangësi janë hasur edhe te kontrata për *“Furnizim me tonerë për printer”* në vlerë 2,106€. Një nga kushtet e veçanta të kontratës ishte që tonerët të jenë origjinal dhe të testohen nga KRK nëse i plotësojnë kriteret dhe i përmbushin standardet e cilësisë. Komisioni i pranimit kishte përgatitur një raport ku konfirmon pranimin e sasisë së kërkuar të tonerëve por pa dhënë ndonjë informatë rreth testimit të cilësisë së tonerëve.

Rreziku Mangësit e tilla vështirësojnë dhe reflektojnë në implementimin e planit të prokurimit, planit buxhetor dhe operativ. Mos zbatimi i kërkesave të kontratës nga komisioni i pranimit në menaxhimin e blerjeve mund të shpie para rrezikut që mallrat e pranuar të mos jenë sipas cilësisë së kontraktuar.

Rekomandimi 3 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se plani i prokurimit pasqyron qartazi furnizimet dhe shërbimet që pritet të realizohen përmes procedurave të prokurimit. Kjo të mbështetet nga njësit kërkuese nga të cilat pritet të ofrojnë informata më të detajuara të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme, të përcjella me hulumtime dhe analiza rreth çmimeve aktuale të tregut. Poashtu, AQP të njoftohet me kohë për aktivitetet e pa planifikura të prokurimit. Te menaxhimi i kontratave, komisionet e pranimit të mallrave të zbatojnë në tërësi kërkesat kontraktuale gjatë pranimit të mallrave, dhe raportet e pranimit të ofrojnë informata të mjaftueshme dhe të konfirmojnë përmbushjen e plotë të kushteve të kontratës.

² “Furnizim me pajisje dixhitale për sallat konferenciale N205, N409 dhe kabinet”, në vlerë 99,931€, “Mirëmbajtja mujore dhe servisimi i liftave në ndërtesën e KRK-së” me vlerë të parashikuar prej 20,000€; dhe “Furnizim me goma vere për automjetet e KRK-së” me vlerë 3,000€.

³ LPP neni 9 – për aktivitetin i cili nuk është i përfshirë në planin e prokurimit, ZKA i AK-se duhet të njoftoj AQP-në 5 ditë para fillimit të procesit të prokurimit.

⁴ Aneks kontrata është nënshkruar me 10.09.2015.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Shpenzimet jo përmes prokurimit nënkuptojnë të gjitha ato blerje të cilat nuk kërkojnë aplikimin e procedurave të prokurimit publik, si shpenzimet e mëditjeve për udhëtime zyrtare, shpenzimet e trajnimit, komunale, etj. Testimet e mostrave në këtë fushë nuk kanë rezultuar me ndonjë parregullësi.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Shpenzimet bruto për paga dhe mëditje për vitin 2015 ishin 6,060,091€ apo 76% e buxhetit të përgjithshëm vjetor të KRRK-së. Përveç pagave bazë, punonjësit e administratës së Kuvendit dhe stafi mbështetës politik përfitojnë edhe kompensime shtesë të aprovuara me akte të veçanta dhe vendime të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pagesa e pagave dhe mëditjeve bëhet përmes një sistemi të centralizuar. Fokus i auditimit në këtë fushë ishin listat e pagave dhe kompensimet shtesë, dosjet e personelit, vlerësimet vjetore të punonjësve dhe rekrutimet e personelit.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.5.2 Subvencionet dhe Transferet

Për vitin 2015 KRRK kishte 120,000€ buxhet të planifikuar për subvencione. Deri në fund të vitit tërë buxheti i kësaj kategorie është shpenzuar. Nga ky fond, entitetet publike kishin përfituar 101,800€, entitetet jopublike 1,500€, dhe përfituesit individual 9,900€. Subvencionet e dhëna ishin aprovuar nga Kryetari i Kryesisë së Kuvendit. Përfituesit e subvencioneve kishin ofruar raporte rreth aktiviteteve të subvencionuara.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.6 Pasuritë dhe detyrimet

3.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas Sistemit Informativ për Menaxhimin Financiar të Kosovës (SIMFK) vlera neto e pasurisë kapitale në fund të vitit 2015 ishte 6,576,326€. Përveç pasurisë jokapitale nën 1,000€ të blerë para vitit 2011, pasuria tjetër jokapitale nën 1,000€ dhe materiali shpenzues menaxhohet përmes sistemit e-pasuria. KRK disponon edhe një regjistër në formatin excel, ku ka të evidentuar pasurinë e përgjithshme. Në fund të vitit ishte bërë edhe inventarizimi i pasurisë. Në vitin 2016, menaxhmenti kishte dërguar zyrtarët për menaxhimin e pasurisë në trajnimin për përdorimin e programit e-pasuria, me qëllim evitimin e disa mangësive ekzistuese në këtë fushë.

Çështja 4 – Menaxhimi jo i duhur i pasurisë jo kapitale – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Pasuria jo kapitale nën 1,000€ e blerë para vitit 2011 nuk është regjistruar në regjistrin e-pasuria, por në një listë në formatin excel.
- Rreziku** Regjistrimi i pasurisë në dy databaza të ndryshme vështirësonë menaxhimin efektiv të saj. Edhe informatat financiare rreth pasurisë mund të mos përmbushin kërkesat e kontabilitetit dhe raportimit financiar.
- Rekomandimi 4** Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se pasuritë jo kapitale regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit për menaxhimin e pasurisë e-pasuria.

3.6.2 Trajtimi i borxheve

Në pasqyrat vjetore financiare janë shpalosur obligime të pa paguara në vlerë 50,226€. Borxhet kanë të bëjnë me shpenzimet për dreka zyrtare, derivate, ngrohje, shpenzime telefonike, si dhe shpenzime komunale. Obligimet nuk ishin paguar ngase faturat ishin pranuar në fund të vitit. Këto detyrime do të paguhen me buxhetin e vitit 2016. KRK është e ekspozuar edhe ndaj detyrimeve kontigjente përkatësisht pretendimeve financiare që operatorët ekonomik presin nga KRK. Vlera e tyre e prezantuar në PVF është 96,283€.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Menaxhmenti duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
2.2 PVF dhe kërkesat tjera për raportim.	Raporti i kontratave publike, që dorëzohet në KRPP, të përfshijë të gjitha kontratat vjetore të realizuara përmes procedurave të prokurimit.	Është implementuar.		
3 Adresimi i rekomandimeve	Plani i veprimit të përcaktojë qartazi afatet kohore dhe veprimet praktike që duhet ndërmarrë nga stafi përgjegjës në zbatimin e rekomandimit.	Përveç rekomandimit për menaxhimin e pasurisë, rekomandimet tjera janë implementuar.		
4.1 Qeverisja e mirë	Të bëhet një rishikim i rregullimeve ekzistuese të delegimit të përgjegjësiave. Detyrat dhe funksionet të cilat bien ndesh nga ushtrimi i tyre nga i njëjti zyrtar të ndahen në pajtim me praktikën, kërkesat dhe rregullat në fuqi.	Është implementuar.		
4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Të bëhet një vlerësim sistematik i arsyeve në lidhje me nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit, me fokus të veçantë për investimet kapitale dhe të përcaktojë opsione praktike për avancim të ekzekutimit buxhetor para përcaktimit të programit kapital të vitit 2015.	Është implementuar.		
4.3.1 Prokurimi	Të vlerësohet arsyeshmëria dhe nevoja e kontratës për mirëmbajtje të softuerit. Përndryshe, kushtet e kontratës duhet të jenë subjekt i rishikimit dhe të përcaktohet qartë forma dhe mënyra e shërbimeve të mirëmbajtjes.	Është implementuar.		

	Të sigurohet se komisionet vlerësuese marrin parasysh vetëm ofertuesit që përmbushin kriteret e kërkuara.	Është implementuar.		
	Procedurat dhe kërkesat ligjore zbatohen gjatë gjithë kohës duke filluar që nga procesi i planifikimit të nevojave dhe zotimit të mjeteve, kontraktimi e deri te monitorimi i implementimit të kontratave. Arsyet dhe shkaktarët që kanë ndikuar në anulimin e shpeshtë të aktiviteteve të prokurimit të analizohen, dhe se rezultatet e analizave të merren parasysh në proceset e ardhshme të prokurimit.	Është implementuar.		
4.4.1 Menaxhimi i pasurisë	Të gjitha procedurat dhe kërkesat ligjore zbatohen me rastin e regjistrimit, menaxhimit dhe njëhësisimit fizik të pasurisë.		Është adresuar.	
4.5.2 Trajtimi i borxheve	Obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda 30 ditëve nga pranimi i faturës. Nëse për çfardo arsye detyrimet ngelin të papaguara, ato duhet të raportohen brenda afatit ligjor në MF/Thesar.	Është implementuar.		

Shtojca IV: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it

Te gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga KRRK ne rast te mospajtitimit	Pikëpamja e ZAP-it
<p>Çështja 1 – Menaxhimi i rrezikut – Prioritet i mesëm</p> <p>E gjetura - KRRK ka hartuar një dokument me të cilin ka identifikuar sfidat apo vështirësit me të cilat përballet gjatë aktiviteteve të përditshme, por se në atë regjistër nuk janë dokumentuar masat apo veprimet që synohen të ndërmerren në tejkalimin e tyre.</p>	Jo	<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës për çdo vit identifikon dhe ka regjistrin e vështirësive dhe formave të rrezikut me të cilat mund të përballet.</p> <p>Masat dhe veprimet e ndërmarra janë në dokumente tjera siç janë plan i veprimit në zbatim të rekomandimeve të ZAP-it dhe auditorit të brendshëm apo edhe në menaxhimi duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.</p> <p>Bazuar në këtë nuk qëndron konstatimi së është prioritet i lartë.</p>	<p>Pavarësisht nëse masat dhe veprimet për menaxhimin e rreziqeve janë paraparë në dokumentet tjera, ato duhet të përfshihen në regjistrin e rreziqeve.</p> <p>Andaj, rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.</p>
<p>Çështja 2-Implementim i ulët i rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm – Prioritet i mesëm</p> <p>E gjetura - Auditimi i Brendshëm kishte vlerësuar implementimin e rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të auditimit të brendshëm</p>	Jo	<p>Rekomandimet e bazuara dhe të zbatueshme janë adresuar.</p> <p>Të njëjtat janë në proces të implementimit nga drejtoritë përkatëse në administratë duke u bazuar në planin e veprimit.</p> <p>Nuk qëndron konstatimi për prioritet të lartë.</p>	<p>Niveli i implementimit të rekomandimeve ka qenë i ulët.</p> <p>Përveç konstatimit tonë, kjo gjendje është konfirmuar edhe nga vet Auditori i Brendshëm i Kuvendit në raportin e tij “Implementimi i rekomandimeve” të datës</p>

duke konstatuar se pjesa më e madhe e rekomandimeve nuk janë adresuar.			18.03.2016. Sipas këtij raporti, nga 20 rekomandime të dhëna për 2015, vetëm dy prej tyre janë implementuar. Andaj, rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.
--	--	--	---